

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

08.03.2021

Ora 12:18

RENDI I DITËS

Projektakti “Për miratimin e gazetarëve dhe operatorëve të Report Tv, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli, N.Mezani**
- **Parti Politike: PD (I.Kaso), LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Televizioni Report TV, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për dokumentacionin përkatës për akreditimin e 74 (shtatëdhjetë e katër) gazetarëve dhe operatorëve teknikë afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni Report TV është një nga televizionet informative dhe të pavarur në panoramën mediatike shqiptare. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimi nr.2 të vitit 2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e gazetarëve dhe operatorëve të Televizionit Report TV. Faleminderti!

**Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021**


Z.I.Celibashi: Atëherë miratohet dhe kërkesa e Televizionit Report TV për akreditimin e 74 (shtatëdhjetë e katër) gazetarëve dhe operatorëve teknikë për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Faleminderit!
Nëse dhe përfaqësuesit e partive politike nuk kanë gjë për të shtuar..

Z.Sh.Sulo: Kryetar, meqenëse ne sot miratuam dokumentacionin e punës që do të përdorin komisionet e qendrave të votimit, në muajin shkurt mos gabohem ka qenë një projektvendim për caktimin e partive politike për sa i përket anëtarëve të tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit. Nuk e di kur mund të zhvillohet, kur mund të futet si rend dite?

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Jemi duke punuar për këtë, paketën e një ose dy akteve dhe shumë shpejt do ta prezantojmë, fillimisht për njohje për ju dhe pastaj për ta miratuar dhe për të organizuar dhe procedurën përkatëse të caktimit. Seanca mbyllet faleminderit ditë të mbarë dhe gëzuar festën.

Vendimi nr.114

**Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

**08.03.2021
Ora 12:17**

RENDI I DITËS

**Projektakti “Për miratimin e gazetarëve të qendrës “BIRN ALBANIA”, për
vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli, N.Mezani**
- **Parti Politike: PD (I.Kaso), LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Rrjeti i Raportimit Investigativ për Ballkanin (BIRN) ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Rrjeti Ballkanik i Raportimit Hulumtues (BIRN), është organizatë jo qeveritare që promovojnë lirinë e fjalës të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike në Europën Jugore dhe Lindore e cila ka dëgën e saj dhe në Shqipëri. BIRN ka vëzhguar dhe proceset e mëparshme zgjedhore dhe si e tillë gëzon të drejtën për të vëzhguar zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimet e dokumentacionit konstatohet se është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2 të vitit 2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021**

rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën me gazetarët. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Këta janë vëzhgues afatgjatë apo jo?

Z.Y.Merkaj: Po.

Z.I.Celibashi: Atëherë miratohet kërkesa e Rrjetit Ballkanik të Raportimit Hulumtues (BIRN), për akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr.115

**Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

**08.03.2021
Ora 12:09**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Berat, me kandidat nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Malva Syrja Aliaj”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Z.Ilirjan Celibashi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

2.Stafi KQZ: Z.Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli, N.Mezini

Parti Politike: PD (L.Nuraj), LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Në datën 10.02.2021 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është njoftuar nga Këshilli i Bashkisë Berat krijimi i vakancës nga Këshilltari Zengjin Erika propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Bazuar në nenin 164 pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidat nga lista shumemërore për Partinë Socialiste në këtë këshill bashkiak është kandidati me numër rendor 39, zj. Malva Aliaj. Me shkresën e datës 16.02.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar anëtarit të këshillit bashkiak, kandidatit për dorëzimin e formularit dhe deklarimit. Referuar nenit 11 të ligjit dhe kriminalizimit dhe deklarami dhe revikimi i të dhënave dhe kushteve në përputhje me këtë ligj kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse për këshillin bashkiak të cilit i takon të marrë mandatin e Këshilltarit për vendin e mbetur vakant. Kandidati për Këshilltar

**Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

ka depozituar në KQZ formularin e deklaramit me numër rendor 010 dhe nga verifikimi i formularit dhe deklaramit konstatohet se kandidati nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me ndalimet për zgjedhjet e tij në funksionin e Këshilltarit të Bashkisë Berat. Gjithashtu KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, Zyra e Gjendjes Gjyqësore ku në përgjigje të kërkesës së KQZ-së Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kryer verifikimin e Gjendjes Gjyqësore ku rezulton se kandidati për anëtar të këshillit bashkiak zj. Malva Aliaj nuk ka shënime në sistem. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së KQZ-së. Në këto kushte referuar pikës 2 kreut 5 të vendimit numër 7 të vitit 2016 të Kuvendit, konstatohet së të dhënat e kandidatit për anëtar të këshillit bashkiak zj. Malva Aliaj për Këshillin e Bashkisë Berat nuk përbëjnë kushte për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Ndonjë diskutim, përfaqësuesit e partive politike në lidhje me këtë projektakt? Nuk kemi. Atëherë bazuar në nenet 19 pika 1 shkronja “n” dhe neni 164 pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, neni 11 i Ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kreut 5 të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimet e ndalimet të parashikuara në Ligjin nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

1.Zj. Malva Syrja Aliaj kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat nuk përfshihet në kushtet e mos zgjedhjes për ushtrimin e këtij funksioni.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Berat me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, zj. Malva Syrja Aliaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve Brenda 3 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 116

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

08.03.2021
Ora 11:50

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit
“Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe
Konservatorët” (ABEOK), për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli, N.Mezani**
- **Parti Politike:** **LSI (K.Kolndreu) PDIU (Sh.Sulo) PD (L.Nuraj)**

Z.I.Celibashi: Atëherë në seancën publike të ditës së sotme, kemi për shqyrtim këto çështje: Shqyrtimi i kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët”, për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 25 prill 2021. Kemi shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Elton Lahim Debreshi, si kandidat për deputet, i propozuar nga zgjedhësit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, në zonën zgjedhore Qarku Dibër. Pika e tretë ka të bëjë me miratimin e dokumentacionit të punës, që do të përdorin Komisionet e Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. Pika e katërt ka të bëjë me përcaktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumenteve që do të përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. Pika e pestë ka të bëjë me plotësimin e vakancës në këshillin e

**Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021**

bashkisë Berat, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Malva Aliaj. Pika e gjashtë ka të bëjë me caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. Pika e shtatë ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së qendrës “BIRN ALBANIA”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. Pika e tetë ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Report Tv, për akreditimin e gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. Atëhere, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës për t’u regjistruar si koalicion, si subjekt zgjedhor të koalicionit “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët”. Po z. sekretar!

Z.Y.Merkaj: Në mbështetje të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, janë regjistruar si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, partitë politike si më poshtë vijon: Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Emigracioni Shqiptar dhe Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë. Në datë 24.02.2021, nëpërmjet kërkesës të bërë nga partia përfaqësuese Partia Kombëtare Konservatore Albania, është kërkuar regjistrimi i koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 prill 2021. Bashkëlidhur kërkesës për regjistrim të koalicionit, është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipër përmendura, për të qenë pjesë e këtij koalicioni. Pas verifikimit përkatës, është konstatuar se dokumentacioni i paraqitur nga këto katër partitë, është në përputhje me nenin 65 të Kodit Zgjedhor dhe si e tillë i kërkohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

**Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021**

regjistrimi i koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Mirë faleminderit! Ndonjë nga përfaqësuesit e partive politike? Ka ndonjë diskutim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Nuk ka. Atëhere meqënëse kërkesa e këtyre partive për t'u regjistruar si koalicion zgjedhor për zgjedhjet e datës 25 prill 2021, është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, vendos:

- 1.Të regjistrojë koalicionin “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët” me shkronja nistore (ABEOK), si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, me parti pjesëtare të tij si më poshtë: Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Emigracioni Shqiptare, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi Nr. 117

**Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

08.03.2021
Ora 11:54

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Elton Lahim Debreshi, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli, N.Mezani**
- **Parti Politike:** **LSI (K.Kolndreu) PDIU (Sh.Sulo) PD (L.Nuraj)**
- **Përfaqësues ligjor i z.Elton Dobreshi Z. Gentian Seriani**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës!

Z.Y.Merkaj: Referuar nenit 69, pika 1, të Kodit Zgjedhor, një grup zgjedhësish në një zonë zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për zonën zgjedhore i cili përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 45 të Kushtetutës dhe nenit 63 Kodit Zgjedhor, jo më vonë se 50 ditë nga dita e zgjedhjeve. Me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, numër 63, datë 11.02.2021, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, një Komitet Nismëtar i cili do të organizojë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për paraqitjen e z. Elton Debreshi, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Dibër, për zgjedhjet e datës 25 prill 2021. Bazuar në nenin 69, pika 1 dhe nenin 72 të Kodit Zgjedhor, Komiteti Nismëtar në datën 24.02.2021, ka paraqitur në

**Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021**

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nënshkrimet mbështetëse të 1350 zgjedhësve, të cilët shprehen se janë përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, të zonës zgjedhore Qarku Dibër. Në mbështetje të nenit 71, pika 3 është ftuar Komiteti Nismëtar për të qenë prezent në seancën publike dhe ka paraqitur me autorizim është paraqitur avokati Gentian Seriani, i cili është në seancë. Referuar ekstraktit të fundit të listës së zgjedhësve rezulton se Qarku Dibër ka 130830 zgjedhës. Sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 69, numri i zgjedhësve që i korrespondon kufirit minimal prej 1% të zgjedhësve, është 1308 zgjedhës. Pasi janë verifikuar nënshkrimet e zgjedhësve nga lista e mbështetësve e qarkut Dibër, rezulton se janë dorëzuar gjithsej 1350 nënshkrime, të plotësuara sipas modelit 06, si dhe është depozituar dhe kopja e letër njoftimit të nënshkruara prej tyre. Në përfundim të verifikimit të nënshkrimeve, rezulton se numri i zgjedhësve që kanë nëshkruar në listë duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të pa rregullta, është më i madh se kufiri minimal i përcaktuar në nenin 70, pika 8 e Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 11 të ligjit të dekriminalizimit, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat për deputet. Në përputhje të nenit 5, pika 4, kandidati i pavarur për deputet z. Elton Debreshi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 012, datë 24.02.2021. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimin për ndalim për ligjin për dekriminalizimin. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka treguar informacion, verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton se nuk ka shënime, në sistem. Referuar nenit 2, të ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacioni i ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për z. Elton Debreshi, nuk përbën kusht për refuzimin e regjistrimit të tij si kandidat i pavarur në Qarkun Dibër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill

**Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021**

2021. Në këto kushte i kërkojmë, i propozojmë, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, regjistrimin e z. Elton Debreshi si subjekt zgjedhor, i propozuar nga zgjedhësit, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit z.sekretar! Nga përfaqësuesi i Komitetit Nismëtar për regjistrimin kandidatit të mbështetur nga zgjedhësit? Nuk kemi asnjë gjë. Atëhere meqënëse nga verifikimet që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka bërë dokumentacionit të paraqitur nga Komitetit Nismëtar përkatës për regjistrimin e këtij kandidati, rezulton se ai është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, vendos:

- 1.Të regjistrojë z. Elton Lahim Debreshi, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit, për deputet për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi Nr. 118

**Zbardhi materialin audio
Romina Kokoshi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

08.03.2021
Ora 11:58

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e dokumentacionit të punës që do të përdorin Komisionet e Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli, M.Mezani**
- **Parti Politike: PD, LSI , PDIU**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Në zbatim të përcaktimit të nenit 42, të Kodit Zgjedhor, janë përgatitur modelet e dokumentacionit që do të përdorin komisionet në qendrat e votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Dokumentacioni që paraqitet për shqyrtim dhe miratim është i plotë për dokumentimin e punës, veprimtarisë dhe vendimmarrjes në respekt të përcaktimit të Kodit Zgjedhor, lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Qendrës së Votimit për organizimin dhe administrimin e zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit. Bashkëlidhur projektvendimit paraqiten dhe modelet e dokumentacionit përkatës si më poshtë: libër protokoll i mbledhjeve, regjistër i posaçëm i zgjedhësve, si dhe për administrimin e dokumentacionit të materialit zgjedhor dhe të vendimeve, e cila është parashikuar sipas modeleve, nga modeli KQV 01 me numër rendor rritës deri

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021**

në modelin KQV 17, specifikimet teknike të zarfeve dhe për dokumentacionin e materialit zgjedhor si dhe procesverbalet janë paraqitur në lidhjen nr.1, bashkëlidhur këtij projektvendimi. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe modelet e Komisionit të Qendrës së Votimit. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Në dallim nga zgjedhjet e kaluara, çfarë ndryshimesh kemi në lidhje me këto modele? Ka ndonjë ndryshim, apo nuk ka ndonjë ndryshim?

Z.Y.Merkaj: Kemi thjesht, vetëm kemi emërtuar me numër rendor rritës, nga 1 deri tek 17. I kemi pasur të shpërndara dhe nuk i kemi pasur sipas këtij formati të emërtuara. Kurse informacioni brenda është i njëjtë.

Znj.A.Tenolli: Tek procesverbali nr.8, që është ai i mbylljes së votimit, rubrika përkatëse për pasqyrimin e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar në qendrën e votimit, referon dy alternativa. Ata të identifikuar nga pajisjet elektronike dhe identifikimit të zgjedhësve, si dhe ose nënshkrimet e zgjedhësve në listën e zgjedhësve për të parë, paraparë të dy situatat. Rastin kur, pajisja elektronike vazhdon dhe funksionon normalisht gjatë gjithë ditës së votimit deri në mbylljen e tij, si dhe rastin kur për defektet teknike mund të ndodhë që votimi të realizohet pa pajisjen e identifikimit elektronik të zgjedhësve. Gjithashtu, i është shtuar një procesverbal, procesverbali nr.9, i cili në kompozimin e tij ka 3 rubrika dhe do të shërbejë për dorëzimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve nga qendra e votimit në hapat vijues, deri në përfundimin e dorëzimit të saj në KQZ. Ky procesverbal është konceptuar me 3 rubrika për të qenë më lehtësisht i administrueshëm, i përdorshëm dhe për të referuar saktë nga të gjithë etapat, nga

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

të gjithë personat që do të përfshihen në këtë proces. Faktin, nëse gjatë dorëzimit ka pasur incidente apo problematika. Këto janë dy ndryshimet.

Z.I.Celibashi: Po, faleminderit! Kemi ndonjë diskutim nga përfaqësuesit e partive politike, në lidhje me përmbajtjen e këtyre modeleve? Nuk kemi! Mirë, atëherë! Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “b” dhe “n”, paragrafi 2, neni 42, vijues të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë vendos të miratoj dokumentacionin e punës që do të përdorin komisionet e qendrave të votimit për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, si më poshtë: libër protokollit i mbledhjeve të KQV-së, regjistër i posaçëm i zgjedhësve,

1.3-shi për administrimin e dokumentacionit. Çfarë është kjo Ana? Për administrimin e dokumentacionit, është procesverbal? Po pra, duhej thënë, procesverbal për administrimin e dokumentacionit e materialit zgjedhor dhe marrjen e vendimeve. Ah, e thjeshtë, është lista e këtyre më poshtë.

Model KQV 1, zarfi i procesverbalit i vulosjes së kutive të votimit

Model KQV 2, zarfi i fletëvotimeve të papërdorura

Model KQV 3, zarfi i fletëvotimeve të dëmtuara.

Model KQV 4, zarfi i vërtetimit të identifikimit elektronik të zgjedhësit.

Model KQV 5, procesverbali i pezullimit të votimit.

Model KQV 6, procesverbal i rifillimit të votimit.

Model KQV 7, procesverbal i vulosjes së kutisë së votimit.

Model KQV 8, procesverbali i mbylljes së votimit.

Model KQV 9, procesverbal i vulosjes së kutisë së pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve.

Model KQV 10, vendim për caktimin e detyrave të anëtarit të KQV-së.

Model KQV 11. vendim për hapjen e votimit.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

Model KQV 12, vendim për largimin e personave të caktuar nga mjediset e qendrës së votimit.

Model KQV 13, vendim për pezullimin e votimit.

Model KQV 14, vendim për kërkimin e ndihmës nga policia për rivendosjen e rendit në qendrat e votimit.

Model KQV 15, vendim për largimin e punojësve të policisë nga qendrat e votimit.


Model KQV 16, vendim për mbylljen e votimit,

Model KQV 17, vendim për caktimin e numrit të personave që kanë votuar në qendrën e votimit.

Pika 1.4. Specifikimet teknike, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tri ditëve, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi.119

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

**08.03.2021
Ora 12:12**

RENDI I DITËS

Projektakti “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :


- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli, N.Mezani**
- **Parti Politike: PD (I.Kaso), LSI (A.Kaziaj), PDIU (Sh.Sulo)**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas përcaktimit të nenit 93, paragrafi 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private ku nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose një zonë qendre votimi fqinj. Komisioni Rregullator me Udhëzimin nr.1 datë 05.12.2020 ka përcaktuar rregullat tek kriteret që ndiqen në rastet kur kryetari i njësisë së qeverisjes vendore i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të zgjedhë caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit në ambiente private. Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përmes këtij relacioni i paraqitet për shqyrtim dhe miratim propozimet e kryetarëve të njësisë së qeverisjes vendore për caktimin e vendndodhjes së 317 qendrave të votimit në ndërtesa private. Nga kryetarët e bashkive për cdo propozim të paraqitur për caktimin e vendndodhjes së

1

**Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

qendrës së votimit në ndërtesë private është referuar mungesa e ndërtesave publike në zonën e qendrës së votimit apo në ndonjë zonë fqinj. Është paraqitur dokumentacioni dhe janë referuar të dhënat sipas kritereve të përcaktuar në Udhëzimin nr.1 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator. Pozicioni gjeografik i ndërtesave private të përcaktuara për vendodhjen të qendrës së votimit përgjithësisht është në qendër ose afër qendrës së zonës së qendrës së votimit. Konfirmohet se ndërtesat nuk përdoren apo nuk janë në pronësi pjesërisht ose tërësisht të një partie politike, kandidatë ose të afërm të tij. Gjithashtu është referuar se pronari i ndërtesës i është propozuar dhe është dakortësuar për ta përdorur ambientin e tij si qendër votimi. Kemi marrë propozimet e kryetarëve të Bashkisë Malësi e Madhe, Bashkisë Shkodër, Lezhë, Mirditë, Kurbin, Bulqizë, Dibër, Mat, Bashkisë Klos, Kamëz, Rrogozhinë, Tiranë, Vorë, Kavajë, Cërrik, Librazhd, Gramsh, Bashkisë Elbasan, Belsh, Peqin, Ura Vajgurore, Bashkisë Berat, Kuçovë, Lushnje, Fier, Bashkisë Mallakastër, Divjakë, Patos, Shijak, Durrës, Krujë, Korçë, Bashkisë Devoll, Pogradec, Gjirokastrë, Tepelenë, Selenicë, Vlorë, Himarë dhe Sarandë. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtimin e miratim si dhe dokumentacionin përkatës. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Projektaktin e kemi konsultuar dhe me përfaqësues të partive politike, ua kemi dërguar dhe kemi dakordësuar.

Z. Y. Merkaj: Po projektakti është konsultuar me përfaqësuesit e partive politike, por gabimisht tek lista që kemi dërguar kemi 319 qendra votimi, në fakt janë dy qendra votimi që nuk janë shqyrtuar akoma dhe propozimi të hiqet nga lidhja bashkëlidhur e këtij projektvendimi është qendra e votimit nr. 871 dhe qendra e



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

votimit nr. 1722\1 të cilat janë aktualisht te lidhja por duhet të hiqet, pasi nuk ka përfunduar shqyrtimi.

Z. I. Celibashi: Për të gjithë të tjerat nuk kemi asnjë problem, jemi dakortësuar. Përfaqësuesit e partive politike keni ndonjë diskutim? Nuk kemi.

Atëherë bazuar në nenin 19 paragrafi 2, nenin 93 paragrafi 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Nenit 3 të Udhëzimit të Komisionit Rregullator nr.1 datë 05.12.2020 "Për caktimin e rregullave për ngritjen dhe caktimin dhe njoftimit e vendodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së Njësisë së Qeverisjes Vendore për zgjedhjet, ndonjë fjali këtu.


Vendos "Caktimin e vendodhjes së qendrave të votimit në ndërtesa private për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021", sipas lidhjes 1 bashkëlidhur duke hequr nga lidhja qendrën e votimit nr.871 dhe nr. 1722\1. Kryetarët e njësisë të vetëqeverisjes vendore të kryejnë menjëherë njoftimin me shkrim të zgjedhësve për vendodhjen e qendrave të votimit të caktuara në këtë vendim.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sankioneve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr.120

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

08.03.2021

Ora 10:00

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Hedhje e shortit për monitoruesit e Qarkut Lezhë dhe Shkodër"

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Stafi KQZ: Y.Merkaj, E.Dai, E.Podgorica

Z.Y.Merkaj: Përshëndetje, siç jeni në dijeni, në datën 23 Shkurt dhe 04 Mars u zhvillua shorti për të përzgjedhur monitoruesit që do të monitorojnë subjektet zgjedhore dhe kandidatët e pavarur për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021. Procedura edhe sot do të jetë e njëjtë për Qarkun Lezhë dhe Shkodër, pasi këto dy qarqe nuk kishin aplikacionet me *(nuk degjohet)*. Procedura e shortit është e njëjtë si në dy shortet e para. Në një shirit letër do të vendosen emrat e aplikantëve. Shiriti letër vendoset në gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë. Goglat hidhen në një enë transparente dhe një përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i përzier dhe gogla e parë ose emri i parë që do të tërhiqet nga përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është emri i monitoruesit që do të monitorojë për Qarkun Lezhë dhe Shkodër. Për Qarkun Lezhë ka 9 aplikime dhe hidhet shorti për 2 vakanca ndërsa për Qarkun Shkodër ka 2 aplikime dhe hidhet shorti për 1 vakance. Tani të vazhdojmë procedurën e shortit si herët e tjera, faleminderit.

Znj. E.Dai: Hedhim shortin me kandidatët që kanë konkuruar për të qenë monitorues të fushatës zgjedhore në Qarkun Lezhë.

1. Anastas Pjetri

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021**

2. Leonard Cima
3. Anis Tahiraj
4. Elejd Hafizi
5. Sajmira Selmani
6. Altin Gjoka
7. Suada Shyti
8. Shkelzen Margjeka
9. Sebastiano Gjetja

Përzgjedhës për të qenë monitorues të fushatës zgjedhore për Qarkun Lezhë janë:

1. Sajmira Selmani
2. Elejd Hafizi

Hedhim shortin me kandidatët që kanë konkuruar për të qenë monitorues të fushatës zgjedhore në Qarkun Shkodër.

1. Megi Dukeli
2. Rakela Nuhani

I përzgjedhuri për të qenë monitorues të fushatës zgjedhore për Qarkun Shkodër është:

1. Megi Dukeli

Mbyllim shortin!

Vendimi nr.121

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

08.03.2021
Ora 12:04

RENDI I DITËS

Projektudhëzimi “Për caktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin e publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumenteve që do të përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli, M.Mezani**
- **Parti Politike: PD, LSI, PDIU**

Z.I.Celibashi: Mirë vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Bazuar në nenin 119, pika 2, paragrafi 2, i nenit 122, pika 3 të Kodit Zgjedhor është përgatitur projektudhëzimi për përcaktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin dhe publikimit të rezultateve paraprake të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumentacionit që përdoren për nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve për Kuvend. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë rregullat që do të zbatohet për mbledhjen e administrimit dhe publik të rezultatit paraprak të zgjedhjeve, si dhe të miratojë modelet dhe indikacionet që përdoren për nxjerrjen e rezultatit për zgjedhjet për Kuvend. Udhëzimi përmban 10 nene.

Neni 1, është qëllimi.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

Neni 2, përmban informacionet që dërgohet elektronikisht nga KZAZ-ja në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

Neni 3, përcakton përmbajtjen e informacionit për rezultatin e zgjedhjeve.

Neni 4, përcakton kushtet që duhet të plotësojë aplikacioni kompjuterik për hedhjen e transmetimit dhe publikimit të rezultatit paraprak të zgjedhjeve.

Neni 5. përcakton përgjegjësinë për përcjelljen e informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 6. përcakton mënyrën e dhënies së informacionit për rezultatet nga KZAZ-ja në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 7, përcakton publikimin e informacionit për rezultatin paraprak.

Neni 8, përcakton prodhimin dhe administrimin e modeleve të dokumentacionit për rezultatet. Modeli i dokumentacionit që përdoret për nxjerrjen e rezultateve për zgjedhjet të përmendura në këtë udhëzim, prodhojnë, administrojnë, dhe kanë këto formate si më poshtë: tabelë rezultate për qendrën e votimit me modelin KZAZ nr.29 , për subjektet zgjedhore prodhohet në format A3 dhe letër e thjeshtë, ndërsa tabela e rezultateve për QV, model ZAZ 30 , për kandidat për deputet prodhohet në format A4, letër e thjeshtë, tabela përmes rezultateve për ZAZ-të, si për subjekt zgjedhor model ZAZ 31 dhe për kandidatë për deputetë model ZAZ nr. 32 prodhohen në format A3, letër e thjeshtë, modelet e vendimit të ZAZ, model 33 dhe model 34, prodhohen në format A4. Tabelat e rezultateve për qendrat e votimit të printuara dhe të firmosura nga grupi i numërimit, dhe tabelat e rezultateve të plotësuara me shkrim dore nga grupi i numërimit i bashkëlidhen njëra-tjetrës dhe shërbejnë si dokumentacion zyrtar që dorëzohen dorazi nga KZAZ-ja në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, së bashku me tabelat përmbledhëse të rezultateve për zonën e administrimit zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021*

Neni 10, janë dispozitat e fundit ku parashikohet shfuqizimi i udhëzimit të mëparshëm të vitit 2015. Bashkëlidhur kemi shqyrtimin e miratimit e projektvendimit, projektudhëzimit, si dhe modelet e tabelave të rezultateve. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Atëherë, paraprkisht këtë të dhënë, fletë votimi të kontestuar do ta heqim nga përmbajtja e tabelave. Nuk do ta përfshijmë si të dhënë. Sepse mundet të krijojë konfuzion tek, qoftë në rastin e pasqyrimin të rezultatit nga anëtarët e grupit të numërimit, po ashtu dhe nga KZAZ-ja kur të bëjë tabelën përmbledhëse.

Z.Y.Merkaj: Atëherë, kemi dy modele. Tek modeli i ...

Z.I.Celibashi: Tek të gjitha modelet do të hiqet, edhe nga fletë votimi të kontestuara, edhe pse kur e kemi diskutuar fillimisht patëm idenë që kjo ishte një e dhënë që mund të ishte në interes edhe për subjektet, edhe për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Sa kohë që edhe nga pikëpamja e ndërtimit logjik të të dhënave të tjera, kjo nuk ka asnjë domethënie, sepse fletë votimi të kontestuara mund të jenë fletë votimi të vlefshme, të pavlefshme apo ato për subjektet. Kjo mund t'i bëjë ata të mendojnë që duhet ta përputhin këtë si shifër me një shumatore, kështu që, ato janë në procesverbal, janë në zarf, apo jo, nëse nuk gaboj, në zarf të veçantë dhe nëse duhet pastaj ta marrim si të dhënë, ne mund ta marrim. Asnjë nuk ka qenë më përpara, ne synojmë që ta vendosim tani, por pas konsultimeve që kemi bërë, asnjë prej subjekteve nuk e vlerëson si të dobishme këtë të dhënë, biles mendojnë se mund të kryejë një lloj konfuzioni. Nga përfaqësuesit e partive politike ka ndonjë diskutim lidhur me këtë udhëzim?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.03.2021**

Përfaqësuesit e partive politike: Dakord!

Z.I.Celibashi: Mirë, atëherë, e miratojmë udhëzimin sipas projektit të draftit të propozuar, gjithashtu miratojmë edhe të gjitha modelet e tabelave të rezultateve, të cilat lidhen me nxjerrjen e rezultatit për partitë politike, koalicionet dhe kandidatët sipas lidhjes dhe draftit të propozuar. Mirë vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës

Vendimi nr.122

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**

